

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

PROGRAMI PËR GJIMNAZIN E REFORMUAR ARSIMOR

PROGRAMI MËSIMOR

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

VITI III



Shkup, 2003

1. IDENTIFIKIMI I TË DHËNAVE

- 1.1. Emërtimi i lëndës mësimore: **GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**
- 1.2. Lloji i arsimimit të mesëm
- 1.2.1. Drejtimi arsimor : **Për gjimnazet**
- 1.3. Diferencimi i lëndës mësimore
- 1.3.1. Lëndë e përgjithshme
- 1.4. Viti i mësimimit të lëndës mësimore
- 1.4.1. **Viti i tretë**
- 1.5. Numri i orëve të lëndës mësimore
- 1.5.1. Numri i orëve javore: **4 orë**
- 1.5.2. Numri i orëve vjetore: **144 orë**
- 1.6. Statusi i lëndës mësimore
- 1.6.1. **I obligueshëm**

2. QËLLIMI I LËNDËS MËSIMORE

Qëllimi i mësimimit të gjuhës shqipe dhe i letërsisë synon që nxënësi të aftësohet të komunikojë në gjuhën letrare shqipe, t'i përvetësojnë karakteristikat thelbësore të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore dhe t'i aftësojnë për vetëmësim.

2.1. Qëllimi i përgjithshëm

- të komunikojë në pajtim me normën e gjuhës letrare shqipe në jetën e përditshme, në nivel akademik dhe në nivele tjera;
- t'i zbatojë normat gjuhësore në jetën e përditshme (me gojë dhe me shkrim);
- t'i njohë vlerat letrare dhe të zhvillojë aftësi personale në jetën e përditshme dhe atë profesionale;

- t'i zhvillojë aftësitë individuale për përdorim receptiv e produktiv të gjuhës letrare shqipe në formën e shkruar dhe atë gojore;
- të fitojë dituri socio - lingvistike, që do t'i ndihmojë të gjendet në situata të ndryshme;
- të aftësohet për shkollim të mëtutjeshëm nëpër institucionet e arsimit të lartë në aspektin profesional e shkencor;
- të njihet me karakteristikat e letërsisë shqiptare dhe me veçoritë e letërsive të tjera që do ta ndihmojnë njohjen reciproke të kulturave;
- t'i zhvillojë aftësitë e përgjithshme dhe ato të veçanta si: zgjidhjen e problemeve, aftësimin për bashkëpunim, përgjegjësinë përshtatshmërinë dhe kreativitetin;
- Të mund të shfrytëzojë literaturë profesionale (broshura, revista, fjalorë, doracakë) etj;
- Të kenë mundësi edhe mëtej t'i përsosin aftësitë e tyre profesionale në sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional që po bëhet gjithnjë e më interdisciplinar dhe parakusht për kërkimin e informacioneve, mësimin dhe njohjes së gjuhës dhe të letërsisë shqiptare;
- të formojë personalitet me zhvillim permanent të synimeve kognitive (arsimore), psikomotorike (edukative) dhe efektive (funksionale).

2.2. Qëllimi i veçantë i mësimimit

- Të përvetësojë materialin nga fusha e gjuhës shqipe dhe letërsisë;
- Të përvetësojë një fond të mjaftueshëm fjalësh që do të ndihmojnë komunikimin në gjuhën amtare letrare dhe do të jenë të kuptueshëm;
- Të aftësohet të gjejë informacione konkrete nga sfera e gjuhës dhe letërsisë me karakter të përgjithshëm ose personal;
- Të aftësohen të bartin informacione të shkruara ose letra që do të jenë të kuptueshme, gjithashtu nxënësit do të aftësohen për thithjen e vlerave të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore.

3. NJOHURITË E NEVOJSHME PARAPRAKE

Pasi nxënësi e ka kryer vitin e dytë, supozohet se gjatë shkollimit të mesëm (vitit tretë) të gjimnazit, i ka përvetësuar njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e mëposhtme :

- kuptojnë globalisht materialin e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe kanë paranjohuri optimale mbi të njejtën dhe atë botërore;
- zotërojnë një fond të mjaftueshëm fjalësh dhe elementesh gramatikore që u mundëson të shprehen qartë;
- gjejnë informacione dhe elemente të ndryshme gjuhësore në tekste të caktuara dhe nga burime të ndryshme;
- mund të vjelin informacione në sferën e komunikimit, gjuhës dhe letërsisë;

Megjithatë, duhet të potencohet se arsimitari patjetër duhet të ketë perasysh faktin se nxënësi, edhe përkundër arsimit bazë, do të ketë nevojë për aftësim të mëtutjeshëm, veçmas në gjimnaz ku interesimi është më i madh.

4. PROCESI MËSIMOR

4.1. Struktura e përmbajtjeve mësimore

FUSHA PROGRAMORE: KOMUNIKIMI (30 orë)				
Njësitë mësimore	Numri i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi:	Orientimi didaktik	Korelacioni mes lëndëve dhe fushave programore
<p>Tregimi</p> <p>Ta çmojmë shokun</p> <p>Ëndrra dhe fantazia</p> <p>Feja dhe të rinjtë</p> <p>Ta vlerësojmë tolerancën</p>	5	<ul style="list-style-type: none"> - di t'i çmojë rezulttet e shokut, si ato pozitive dhe negative, me gojë dhe me shkrim. - mund të flasë për gjëra intime dhe emocionale, për ëndrrën dhe fantazinë. - di të tregojë se çka paraqet ëndrra dhe çka fantazia. - di të shprehet lidhur me fenë, anët pozitive të saj, sa u ndihmon në formimin e tyre si personalitet. - di t'i shmangët konfliktit, grindjeve, duke organizuar aktivitete të ndryshme. 	<p>Arsimtari do të sqarojë, parashtrijë pyetje, situata, probleme me gojë apo me shkrim; do të përdorë mjete të nevojshme mësimore për realizim si televizorin, radion kasetofonin, kompjuterin etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - do të ushtrohet në grupe të mëdha ose të vogla. -ushtron se ç'është ëndra dhe fantazia. - ushtron rreth asaj se sa feja është pjesë e jetës së tyre. - ushtron se konflikti dhe grindja nuk sjellin asgjë të mirë por vetëm të këqia. 	Letërsi, gjuhësi, arsimit qytetar, psikologji, drejtshkrimi etj.

<p>Ritregimi</p> <p>Ngjarje të përjetuara nga udhëtimi, ditëlindja etj.</p> <p>Filmi</p> <p>Libër i lexuar</p>	<p>4</p>	<p>- mund t'i rrëfejë ngjarjet e përjetuara duke u përqëndruar në kujtimet nga udhëtimet, ditëlindjet apo të ndonjë ahengu a gëzimi shoqëror.</p> <p>- i kupton terminet: regji, regjisor, kameraman, shikues, prezentues etj.</p> <p>- di ti bëjë rezime një libri të lexuar me gojë dhe me shkrim.</p>	<p>- ushtron që ngjarjet e përjetuara t'i ritregojë në mënyrë konkrete.</p> <p>- ushtron rolin e regjisorit, kameramanit etj.</p>	
<p>Diskutimi</p> <p>Tema të ndryshme aktuale</p> <p>Politika dhe të rinjtë</p> <p>Kritika dhe vetëkritika</p>	<p>5</p>	<p>- i kupton problemet aktuale që i rrethojnë të rinjtë, flasin për këto, përpiqen t'i përgjigjen disa pyetjeve duke përcaktuar anët pozitive dhe negative.</p> <p>- kupton se ç'është politika, duhet apo nuk duhet të rinjtë të preokupohen me çështje të tilla fare apo arsyetohet kyçja e tyre në disa segmente të jetës politike.</p> <p>- mund të kyçet nxënësi në lidhje me kritikën dhe vetëkritikën, gjëra që i nevojiten një të riu në formimin e tij.</p>	<p>- ushtron se si duhet të shfrytëzohen informatat nga mjetet e informimit rreth një teme konkrete ku shfaqen mendime të ndryshme.</p> <p>- ushtron që t'i gjejë elementet e vështrimit kritik në vetveten pastaj edhe tek të tjerët</p>	

<p>Noftimi</p> <p>Të shkruajmë njoftime e shpallje</p>	<p>4</p>	<p>- e kupton rolin dhe rëndësinë e njoftimit, shpalljes si pjesë të komunikimit dhe rregullat gjatë shkrimit të tyre.</p>	<p>- ushtron se si shkruhet njoftimi, shpallja dhe rolin e tyre gjatë komunikimit.</p>	
<p>Të shkruajmë parathënie, pasthënie</p>		<p>- i kupton rregullat e të shkruarit të parathënies, pasthënies në libra e romane.</p>	<p>- ushtron të shkruajë parathënie dhe pasthënie të librit.</p>	
<p>Gjatë vitit shkollor do të bëhen katër hartime</p>	<p>12</p>	<p>- do të njihen me shkrimin e hartimeve, me stilin dhe gjuhën që është më i përshtatshëm për një hartim të suksesshëm.</p> <p>- di të bëjë radhitjen logjike të gjërave, korelacionin e duhur dhe etapat e hartimit (hyrja, pjesa kryesore, përfundimi).</p> <p>- di të përdorë shprehje dhe fraza sa më të kuptueshme që në fakt përcaktojnë qëllimin kryesor të hartimit.</p>		

FUSHA PROGRAMORE GJUHË (40) ORË VITI III

Përmbajtjet	Nr. i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi të:	Orientimi didaktik	Korelacioni mes fushave programore dhe lëndëve
<p>Historia e gjuhës së shkruar shqipe</p> <p>Formimi i gjuhës letrare shqipe</p> <p>Periudha e formimit të gjuhës shqipe - parakalimtare dhe kombëtare</p> <p>Baza dialektore e gjuhës së sotme shqipe</p> <p>Sintaksa e periudhës</p> <p>Periudha Njohuri të përgjithshme</p> <p>Marrëdhëniet e fjalive në periudhë</p> <p>Tipat e periudhave me bashkërenditje</p>		<p>- di për historikun e gjuhës së shkruar shqipe.</p> <p>- di për rolin dhe rëndësinë e formimit të gjuhës letrare shqipe.</p> <p>- di për periudhën e formimit të gjuhës shqipe letrare , periudhën parakalimtare dhe kombëtare.</p> <p>- di për bazën dialektore të gjuhës së sotme letrare shqipe gjatë formimit të saj.</p> <p>- di se periudha është njësi sintaksore e formuar prej dy a më tepër njësisish kallëzuesore që përbëjnë një tërësi të mëvetësishme kumtesore, gramatikore dhe intonacionore, si edhe formimin e periudhave me intonacion dhe mjetet lidhëse.</p> <p>- dallon periudhën me bashkërenditje, me nënrenditje dhe të kombinuara</p> <p>- kupton formimin e periudhës me bashkërenditje dhe bashkimin e tyre</p>	<p>Për realizimin e kësaj përmbajtjeje mësimore arsimtari do të përdorë këto aktivitete:</p> <p>- sqarimin, analizën, sintezën, krahasimin, grumbullimin e materialeve etj.</p> <p>Do të përdorë format mësimore; frontale, individuale, në çifte dhe në grupe.</p> <p>Do të përdorë mjete mësimore: libra të gramatikës, tekste të ndryshme për ushtrime sintaktike, fletëza mësimore, grafoskop, episkop, tabelarë të ndryshëm etj.</p> <p>Ushtron në përdorimin e këtyre fjalive, si psh. E drejta vonon por nuk harron.</p>	<p>Morfologjinë, leksikologjinë , fonetikën, letërsinë.</p>

<p>Fjalitë e bashkërenditura këpujore</p>		<p>- dallon fjalitë e bashkërenditura këpujore dhe përdorimin e tyre.</p>	<p>Ushtron këtë lloj të fjalive si p sh. Agnesa i kishte kryer të gjitha detyrat me kohë, andaj rrinte e qetë.</p>	
<p>Fjalitë me bashkërenditje kundërshtore (adversative)</p>		<p>- mund të shprehet me fjalitë me bashkërenditje kundërshtore, bashkimin e tyre. si p.sh. E drejta vonon por nuk harron.</p>		
<p>5.Fjalitë e bashkërenditura veçuese (disjunktive)</p>		<p>Mësojnë dhe dallon formimin e fjalive të bashkërenditura veçuese dhe bashkimin e tyre.</p>		
<p>Fjalitë e bashkërenditura përmbyllëse (konkluzive)</p>		<p>- dallon fjalitë e bashkërenditura përmbyllëse shprehin diçka që është përfundim, përmbyllje a konkluzion i fjalisë së mëparshme.</p>		
<p>Fjalitë e nënrenditura (hipotaksore)</p>		<p>- dallon fjalitë e nënrenditura që përbëhen prej dy e më tepër fjalish me marrëdhënie të pabarabarta.</p>	<p>Ushtron në përdorimin e këtij lloji të fjalive si p.sh. Leka është nga ata që nuk përkulet. Flakroni shtirrej si i shurdhër.</p>	
<p>Karakteristikat e periudhës me nënrenditje</p>		<p>- kupton karakteristikat e periudhës me nënrenditje.</p>		
<p>Klasifikimi i fjalive të nënrenditura kryefjalore subjektore)</p>		<p>- dallon fjalinë e nënrenditur kryefjalore që kryen funksionin e kryefjalës së fjalisë nga e cila varet.</p>	<p>Për realizimin e kësaj përmbajtjeje mësimore arsimtari do të përdorë këto aktivitete: - sqarimin, analizën, sintezën, krahasimin, grumbullimin e materialeve etj.</p>	

Fjalitë e nënrenditura kallëzuesore (predikative)	- dallon fjalinë e nënrenditur kallëzuesore që në periudhë kryen funksionin e kallëzuesit emëror si dhe të përcaktorit kallëzuesor.	Do të përdorë format mësimore; frontale, individuale, në çiftë dhe në grupe.
Fjalitë e nënrenditura kundrinore (objektore)	- dallon fjalinë e bashkërenditur kundrinore që në periudhë kryen një funksion të ngjashëm me atë të kundrinës.	Do të përdorë mjete mësimore: libra të gramatikës, tekste të ndryshme për ushtrime sintaktike, fletëza mësimore, grafoskop, episkop, tabelarë të ndryshëm etj.
Fjalitë e nënrenditura përcaktore (atributive)	- dallon fjalinë e nënrenditur përcaktore që kryen një funksion të ngjashëm me atë të përcaktorit të shprehur me mbiemër, me emër a përemër.	
Fjalitë e nënrenditura rrethore (adverbiale)	- di për fjalitë e nënrenditura rrethore, formimin e tyre	
Fjalitë vendore (lokale)	- dallon fjalinë vendore që në periudhë kryen funksionin e rrethorit të vendit.	
Fjalitë kohore (temporale)	- kupton fjalitë kohore që tregojnë se kur ndodh ngjarja, kur kryhet veprimi në fjalinë kryesore	
Fjalitë mënyrore (modale)	- dallon fjalinë e varur mënyrore që në periudhë kryen funksionin e rrethorit të mënyrës.	

Fjalitë qëllimore (finale)		- dallon fjalinë e varur qëllimore që tregon qëllimin për të cilin kryhet veprimi i fjalisë kryesore.		
Fjalitë shkakore (kauzale)		- dallon fjalinë e varur shkakore që tregon shkakun ose arsyen e asaj që thuhet në fjalinë kryesore.		
Fjalitë rrjedhimore (konsekutive)		- dallon fjalinë e varur rrjedhimore që tregon marrëdhënie ndërmjet një shkakut të shprehur në fjalinë kryesore dhe rrjedhimit a pasojës së shprehur në fjalinë e varur.		
Fjalitë kushtore (kondicionale)		- dallon fjalinë e varur kushtore që tregon kushtin, nga përmbushja e të cilit varet realizimi ose mosrealizimi i asaj që thuhet në fjalinë kryesore. Mëson edhe vendin e fjalilisë kushtore në periudhë.		
Fjalitë lejore (koncesive)		- dallon fjalinë e varur lejore që tregon një veprim i cili pritet ta pengojë realizimin e veprimit të fjalisë drejtuese, por nuk arrin ta pengojë dhe lejon të realizohet.		
Fjalitë krahasore (komparative)		- dallon fjalinë e varur krahasore që shërben për të krahasuar veprimin a gjendjen e shprehur në fjalinë drejtuese me veprimin a gjendjen e shprehur në fjalinë e varur.	Ushtron për këtë lloj fjalish psh. Hasani, me sa duket, ishte kthyer në kohë.	

Periudha asindetike		- dallon periudhën asindetike...		
Fjalitë e ndërmjetme		- e kupton fjalinë e ndërmjetme e cila hyn në mes një fjalie tjetër a periudhe pa u lidhur organikisht me gjymtyrët e saj.	Ushtron përdorimin e tyre në tekst të panjohur	
Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë		- dallon fjalitë ashtu si janë thënë pa kurrfarë ndryshimesh dhe kombinimesh të ligjëratës së drejtë dhe zhdrejtë.		
Shenjat e pikësimit		- di të përdorë drejtë shenjat e pikësimit, funksionin e tyre: pikës, pikëpyetjes, pikëçuditjes, presjes, pikëpyetjes, dypikëshit, shumëpikëshit, thonjëzave, kllapave dhe vizës		

FUSHA PROGRAMORE : LETËRSI DHE LEKTYRË (70 orë)

Përmbajtjet	Nr.i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi të :	Orientimi didaktik	Korelacioni mes fushave programore dhe lëndëve
Letërsia shqipe e sh. XX	45	- i kupton karakteristikat, tendencat dhe proceset e letërsisë shqipe të kësaj periudhe. - dallon veçoritë e letërsisë së periudhës së Pavarësisë si shprehje të lëvizjeve demokratike të shqiptarëve.	Arsimtari sqaron, komenton , grumbullon materiale, hulumton, analizon, krahason etj. Materiale vizuele-fotografi, tekste të autorëve të kësaj periudhe, shkrime nga gazetat, revistat... Ushtron dhe dëgjon poezi nga kasetat e manjetofonit, të recituara nga artistë të njohur...	Me historinë, gjeografinë, artin muzikor dhe artin figurativ.
Gjergj Fishta		- jeta dhe aktiviteti letrar i shkrimtarit. - di ta zbërthejë strukturën e kryeveprës së tij "Lahuta e malcisë". - dallon elementet epike dhe lirike në veprën e Fishtës...	Tekste origjinale të autorit, fotografi, dokumente, faksimile, skema për analizën e veprës...	Artin figurativ, artin muzikor, filmin...
Faik Konica		- jeta dhe aktiviteti letrar, publicistik e kulturor i autorit. - e kupton funksionin e detajit, përshkrimin dhe mendimin në prozën e tij...	Analizon veprën "Doktor Gjilpëra", tematikën, personazhët, kompozicionin, stilin... Komenton vlerat simbolike të dramës "Izraelitë e Filistinë", përdor materiale vizuele dhe veprat e autorit...	Me artin figurativ...
Fan S. Noli		- jeta dhe veprimtaria poliedrike e Nolit. - i kupton poezitë e tij, mjetet shprehëse... dhe dallon stilin e tij të veçantë...	Komenton veprën "Hi dhe shpuzë". Tekste dhe fotografi për ilustrime....	Veprat e autorit.
Mit'hat Frashëri		- jeta dhe aktiviteti letrar... - dallon vlerat artistike të veprës së autorit...	Komenton lirikat e Lasgushit, larminë tematike, ndërtimin artistik të vargjene të tij... Analizon satirën "Hanko halla",	
Lasgush Poradeci		- i njeh dhe dallon tiparet e lirikës së këtij gjeniu, frymën e re që solli poezia e tij në vitet e '30-ta...		

Ali Asllani		- Bio-bibliografia e autorit... - i dallon elementet realiste dhe ato të humorit, nëntekstin dhe gjuhën alegorike që përdor poeti...	lexon edhe krijime të tjera sipas dëshirës...	Me historinë dhe artet tjera (veçmas me filmin)	
Ernest Koliqi		- jeta dhe vepra letrare e autorit... - i kupton tregimet e librit <i>"Tregtar flamujsh"</i> .. - dallon strukturën e veçantë të veprës së tij...	Komenton veprën <i>"Hija e maleve"</i> dhe gjuhën simbolike të saj...		
Mitrush Kuteli		- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit. - e dallon stilin dhe veçoritë e gjuhës së krijuesit...	Komenton dhe analizon veprën <i>"Netë shqiptare"</i> ...		
Et'hem Haxhiademi		- bio-bibliografia e autorit...	Analizon tragjedinë <i>"Skënderbeu"</i> dhe <i>"Abeli"</i> ...		
Migjeni		- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - i dallon elementet novatore të veprës së Migjenit...	Analizon poezitë dhe novelat e autorit; komenton lërminë tematike, kompozicionin dhe stilin e Migjenit...		Historinë dhe artet tjera.
Esad Mekuli		- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - e kupton poezinë e autorit...	Komenton poezitë e tij...		Artin filmic...
Sterjo Spasse		- jeta dhe vepra e autorit... - i di vlerat filozofike dhe artistike të veprës së Spasses...	Analizon dhe komenton veprën <i>"Pse"</i> ...		
Panoramë e letërsisë botërore	15	- dallon prirjet e ndryshme letrare të letërsisë së fillimit të sh. XX; - i di përfaqësuesit kryesorë të kësaj letërsie...	Materiale vizuale, tekste dhe fragmente të shkëputura nga veprat e disa letrarëve të njohur të kësaj periudhe...		
Honore de Balzak		- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - i di veçoritë krijuese të Balzakut...	Analizon veprën <i>"Xha Gorio"</i> ...		
Gustav Flöber		- bio-bibliografia e autorit... - e kupton veprën letrare të autorit...	Komenton gjuhën dhe nivelin estetik të romanit <i>"Zonja Bovarit"</i> ...	Tekste të autorit...	

Dostojevski		- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - e dallon stilin e veprës së autorit...	Amalizon veprën “ <i>Krimi dhe dënimi</i> ”...	
Sharl Bodleri		- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - i dallon elementet simbolike dhe veçoritë e tjera të veprës së autorit...	Komenton krijimet e librit “ <i>Lulet e së keqes</i> ” sipas rregullave teorike...	Historinë, gjeografinë, filmin dhe arte tjera...
Leon Tolstoi		- jeta dhe aktiviteti i bujshëm letrar i Tolstoit... - kupton problematikën e romaneve të autorit...	Komenton veprën “ <i>Lufta dhe paqa</i> ”...	
1. Miço Kallamata 2. Vath Koreshi 3. Ismail Kadare 4. Agim Cerga 5. Luan Starova 6. Xhabir Ahmeti 7. Ridvan Dibra 8. B. Mustafaja 9. Neshat Tozaj 10. Gabriel G. Marquez 11. Balzaku 12. Viktor Ygo	10	LISTA E LEKTYRAVE <i>“Nën hijen e dordolecëve”</i> <i>“Ujku dhe Uilla”</i> <i>“Pallati i ëndrrave”</i> <i>“Legjenda e vadave”</i> <i>“Koha e dhive”</i> <i>“Lulet në tjegulla”</i> <i>“Stina e ujkut”</i> <i>“Vera pa kthim “</i> <i>“Thikat “</i> <i>“100 vjet vetmi”</i> <i>“Evgjeni Grande”</i> <i>“dëshkimi”</i>	Nxënësit të njihen me veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe asaj botërore që janë në listën e lekturve. Të aftësohen t’i vlerësojnë vlerat pozitive të veprave letrare në aspekt të përmbajtjes dhe formës. Posaqërisht t’i analizojnë idetë e autorit në raport me kohën, vendin dhe temën që trajton. Gjatë vitit të analizohen 7 vepra nga lista e paraparë sipas zgjedhjes së arsimtarit dhe nxënësve.	

4.2. Metodatat mësimore dhe aktivitetet për mësim

Metodologjia e propozuar e mësimin bazohet në supozim se gjuha shqipe përdoret si lëndë mësimore deri në shkallën më të lartë të arsimimit. Arsimtari patjetër të zbatojë metoda funksionale të mësimin, me theks të veçantë në aktivitetet e nxënësit, të cilët bazohen në interesimin e tyre me qëllim që të krijohen kushte të volitshme për mësim. nga metodatat mësimore propozojmë të përdorë parasegjithash atë të bisedës, shpjegimit, demonstrimit, punës në grupe, punës me tekst, në çifte etj... Të respektojë karakterin shkencor të të mësuarit, sistematizimin dhe gradualitetin si dhe të përpiqet të vë në zbatim lidhjen e teorisë me praktikën. Sa i takon gjuhës është e rëndësishme që në mënyrë permanente të shkohet nga niveli funksional dhe ai sistematik, me qëllim që të ruhet motivimi i nxënësve për zbatimin e gjuhës letrare shqipe. T'u mundësohet nxënësve sa më shumë që është e mundur ta shfrytëzojnë gjuhën letrare shqipe në kontekst funksional, si të arritura gjuhësore si dhe ato letrare me qëllim që të mundësohet zbatimi i tyre. Nga format e punës është e udhës që pas asaj frontale të përdoret edhe ajo në grupe, në çifte dhe individuale. Poashtu gjatë realizimit të materialit mësimor arsimtari duhet të përdor sa më shumë mjete mësimore vizuale (libra, fletëza mësimore, pyetësor, revista për të rinj), teknikë (kompjuter, televizor, video, manjefon etj.), me anë të të cilëve do të vijnë në shprehje aktivitetet e nxënësve. Tema të tëra duhet të realizohen me anë të sistemit problemor, kërkimor aktiv të të mësuarit. Aktivitetet e nxënësit do të vijnë vijnë në shprehje përmes: vrojtimit, dëgjimit, shënimit, ushtrimeve, leximit, zgjidhje të problemeve, qoftë në grupe ose individuale, duke ardhur në shprehje puna e pavarur e nxënësit.

Aktiviteti i nxënësit: interesohet, parashtron pyetje, shpreh mendimin e tij, propozon zgjidhje, vështron, zbulon (ndryshime), evidenton të dhëna, kontrollon, përputh mendimet me anëtarët e grupit...

Aktiviteti i arsimtarit: planifikon, bën përgatitje(hapsinore, mjetet mësimore dhe didaktiko metodike), parashtron problemin, jep kahje, ndihmon, koordinon dhe vështron punën e grupeve dhe individëve, jep informata, demonstroi, përcjell, vlerëson (punën e vet dhe të grupit), ven kontakt pozitiv pedagogjik duke komunikuar me nxënësin dhe arsimtarët tjerë.

4.3. Organizimi dhe realizimi i mësimin në lëndën Gjuhë shqipe dhe letërsi

Sipas qëllimit të parashtruar, lënda mësimore realizohet në mësojtore të specializuar për mësim teorik, në dy gjysëmvetet, me orë javore të obligueshme. Puna e pavarur e nxënësit mund të realizohet në shkollë dhe në shtëpi si detyrë shtëpie.

4.4. Mjetet mësimore dhe ato ndihmëse

Për t'u realizuar qëllimi i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi në gjimnaze propozojmë mjetet mësimore:

1. Pajisjet e rëndomta: bankat, karriget, dërrasa (tabelën).
2. Grafoskopin (mund të jetë i përbashkët për më shumë lëndë mësimore).
3. Vend për ruajtje të sigurt të completeve të paraleles dhe të librave me referenca (dolape, rafte).
4. Përdorimi i internetit në hapsirat ku janë të instaluar kompjuterët.
5. Kasetofoni dhe videorekorderi...(TV mund të jetë i përbashkët).

Gjatë realizimi të programit të lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi , nxënësve dhe arsimtarëve u sugjerohen materialet:

1. Libri i leximit (viti i tretë).
2. Libri i gramatikës (viti i tyre të).
3. Teksti i teorisë së letërsisë.
4. Doracaku për nxënës.
5. Doracaku për mësues.
6. Parapagimi i revistave të vlefshme profesionale (përmes shkollës).
7. Përdorimi i fotokopjes dhe aparateve tjera për shtypje.

5. NOTIMI DHE REZULTATET E NXËNËSIT

Dituritë dhe aftësitë e nxënësit do të notohen në mënyrë permanente gjatë tërë vitit dhe në drejtim të motivimit të tij. Notimi duhet t'i përfshijë parasegjithash të gjitha qëndrimet pozitive, dituritë, aftësitë dhe sjelljet e nxënësit me qëllim që të stimulohet për përparim dhe vetëiniciativë të tij. Nxënësi duhet të vlerësohet me 8 nota gjatë vitit shkollor. Ky numër parashihet për dy gjysëm vite. Gjatë gjysëm vitit të parë, 2 nota, të bazuara në dituri, aftësi dhe detyra të kontrollit, 2 nota në fushën e komunikimit dhe 4 nota do të jenë të hartimeve. Aspekti gramatikor dhe ai i drejtshkrimit të gjuhës vlerësohet përmes ushtrimeve dhe detyrave të kontrollit. Pasojat e nxënësve në rast të mosuksesit do të jenë në përputhshmëri me ligjin për shkollat e mesme.

6. PARAKUSHTET MATERIALE DHE KADROVIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

6.1. Karakteristikat themelore të arsimtarit

Arsimtari i lëndës **Gjuhë shqipe dhe letërsi** duhet të posedojë karakteristika personale, profesionale dhe pedagogjike të cilat janë:

- të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psikikisht;
- të njohë gjuhën letrare shqipe dhe shkrimin e saj;
- të mos ketë pengesa në të shprehurit gojor;
- të jetë komunikativ dhe i hapur për bashkëpunim;
- të ketë përgatitje përkatëse profesionale, me ose pa përvojë pune;
- ta dojë punën pedagogjike dhe të përparojë në këtë profesion;
- të jetë organizator i mirë, kreativ dhe i aftë për të zbatuar risi në metodologjinë mësimore etj.

6.2. Normativ i kuadrit mësimdhënës

Lëndën **Gjuhë dhe letërsi shqipe** në shkollën e mesme të gjimnazit mund ta mbajnë mësimdhënësit që kanë kryer:

1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor).
2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Letërsisë Shqipe dhe Gjuhës (drejtimi arsimor).

6.3. Standardi hapsinor

Lënda **Gjuhë dhe Letërsi Shqipe** për ta arritur qëllimin e parashikuar duhet të realizohet në mësojtore të specializuara, ose kabinet i dedikuar për këtë lëndë mësimore.

7. DATA E PËRGATITJES DHE BARTËSI I PROGRAMIT

7.1. Data e hartimit: Maj 2002

7.2. Përbërja e grupit punues :

1. Selver Ramadani - këshilltar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - Kumanovë -bartës;
2. Dr. Xhemaludin Idrizi - profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe (drejtor në Gjinnazin “ Zef Lush Marku” - Shkup;
3. Dr. Zeqir Kadriu - zëvendësdrejtor në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - Shkup;
4. Dr. Mirlinda Krifca - profesor në F. Filologjik-Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe- Shkup;
5. Fatmir Sulejmani - këshilltar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - Tetovë;
6. Qamile Saiti - profesor në gjinnazin “Zef Lush Marku “ - Shkup;
7. Bukurie Mustafa - profesor në SH.M.E. “Arsenij Jovkov” - Shkup.

8. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Data e fillimit: 1.09.2003

9. MIRATIMI I PROGRAMIT MËSIMOR

Programi i lëndës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi u lejua të përdoret me vendimin numër _____
të datës _____ viti 2003